



Pranuar / Dërguar Përmbledhur / Prodator Received / Delivered	01 - 11 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Jednica Org. / Unit	Br. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicitua Quantity
SKPM/SHK/	68/2/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1238/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1238/2023, të datës 02.10.2023 të ankuesit [redacted], me adresë rruga [redacted], Arbëri/Prishtinë, kundër Vendimit AAPSK.Nr.755 të datës 13.09.2023 të Sektorit të burimeve Njerëzore në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1238/2023 e datës 02.10.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II.Mbetet në fuqi Vendimi AAPSK.Nr.755 i datës 13.09.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

A r s y e t i m

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, më datë 09.08.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Referencës:RN0012212 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Pranim të Pasurisë së Sekuestruara dhe Konfiskuar", ku afati për aplikim ka qenë nga data 24.08.2023 deri më datë 31.08.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku përmes Vendimit AAPSK.Nr.732 të datës 05.09.2023 të Udhëheqësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se formularët e vlerësimit të rezultateve në punës nuk janë të nënshkruar.

Kundër këtij vendimi, ankuesi më datë 11.09.2023 ka parashtruar ankesë në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, ndërsa Sektori i Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar më datë 13.09.2023 ka nxjerr Vendim AAPSK.Nr.755 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi vendimin e kontestuar.

Ankuesi kundër Vendimit AAPSK.Nr.755 të datës 13.09.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, më datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë më numër protokolli 6353/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 04.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Ndërsa Këshilli me datë 10.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.10.2023 me numër protokolli 6353/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin AAPSK.Nr.732 të datës 05.09.2023 të Udhëheqësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar; Ankesën e datës 11.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar; Vendimin AAPSK.Nr.755 të datës 13.09.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës i datës 31.01.2023 dhe 24.01.2022; Njoftimin e datës 18.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.10.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 10.10.2023; Vendimin me Nr. 395 të datës 31.05.2023; Vendimin me Nr. 5/9/4 të datës 01.08.2023; Konkursin me Nr. Referencës: RN0012212 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën *Udhëheqës i Sektorit për Pranim të Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar*; Listën e kandidatëve të pranuar dhe refuzuar; Njoftimin e datës 06.09.2023; Emailin e datës 07.09.2023 nga O.S për ankuesin; Emailin e datës 07.09.2023 nga ankuesi për O.S; CV-në e ankuesit; Diplomën me Nr. 5018; Vendimin me Nr prot: 742 të datës 06.11.2015; Vërtetimin e datës 14.08.2023; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 01.12.2015; Kërkesën për lëshimin e kartelës identifikuese; Kontratë Punësimi e datës 03.08.2009; Akt Emërimit e datës 17.08.2012, 24.12.2014; Rekomandimin për përtëritjen e kontratës datë 25.06.2009; Certifikatën për periudhën 12-14.09.2011; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punës 31.01.2023 dhe 24.01.2022 të panënshkruara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit AAPSK.Nr.755 të datës 13.09.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, pretendon se afati për aplikim ka qenë shtatë ditë nga data 24.08.2023 deri më datë 31.08.2023; pretendon se refuzimi i aplikacionit për shkak që nuk kanë qenë formularët e vlerësimit të rezultateve në punë të panëshkruar është arsyetim i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm ndërsa me ankesën e parashtruar i kam bashkangjitur formularët e nënshkruar, ndërsa më është refuzuar ankesa; pretendon se është anuluar konkursi ende pa u plotësuar afati kohor për ankesat e mundshme.

Kolegji i Këshillit, konstaton se në konkursin Nr.Referencës: RN00012212 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Pranim të Pasurisë së Sekuestruara dhe Konfiskuar", kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve- Specialit i shkencave shoqërore Juridik, Ekonomik (pas specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale.*
- **Përvoja e punës:** *Se paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Në pikën 5 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, Kopje e dëshmisë së punësimit; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; Kopjet e vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit; Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.*

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit e që ndërlidhen ne afatin e aplikimit i cili pretendon se ka qenë shtatë ditë nga data 24.08.2023 deri më datë 31.08.2023, Kolegji i Këshillit, konstaton se Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, më datë 09.08.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Referencës: RN0012212 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Pranim të Pasurisë së Sekuestruara dhe Konfiskuar", ku afati për aplikim ka qenë nga data 24.08.2023 deri më datë 31.08.2023, bazuar në këtë sipas nenit 38 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (që ka qenë në fuqi në këtë periudhë, ndërsa ky sqarim vlen në të gjitha emërtimet tjera në këtë tekst e që ndërlidhet me këtë ligj, pa e përsëritë më poshtë), është përcaktuar se: "3. Fillimi i procedurës së konkurrimit shpallet në afat jo më të shkurtër se 15 ditë nga data e caktuar për paraqitjen e aplikimit, në web faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme", ndërsa me nenin 43 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,

është përcaktuar se: *"1. Shpallja e konkurimit për lëvizjen brenda kategorisë (në tekstin e mëtejme: "konkurimit") bëhet të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara afatit të përcaktuar për pranimin e aplikacioneve nga kandidatët", në kuadër të kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar me rastin e shpalljes së këtij konkursi ka respektuar afatet e përcaktuar me këto dispozita, ngase njoftimi është bërë më datë 09.08.2023 derisa aplikimi ka filluar të rrjedh nga data 24.08.2023, që nënkupton se ky afat nuk ka qenë më i shkurtër se afati prej 15 ditësh nga dita e caktimit të afatit për aplikim. Po ashtu duke marr parasysh afatin për aplikim i njëjti ka qenë nga data 24.08.2023 deri më datë 31.08.2023, kështu që nëse i referohemi dispozitave të nenit 9 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: "Afati për pranimin e aplikacioneve, nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe jo më i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike", kështu që duke marr për bazë që kjo dispozitë aplikohet përshtatshmërisht edhe për konkuset për lëvizje brenda kategorisë siç parashihet me 43 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje, atëherë afati për aplikim për këtë pozitë nuk ka qenë më i shkurtër se tetë (8) ditë, ngase nga data 24.08.2023 deri më datë 31.08.2023 janë plotësisht tetë (8) ditë, me çka ky pretendim i ankuesit është i pabazuar.*

Ndërlidhur me pretendimet e ankuesit për refuzim të aplikacionit, Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh aplikacionin e ankuesit po ashtu edhe dokumentacionet e dorëzuara me rastin e aplikimit, konstatohet fakti se ankuesi formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022 dhe vitin 2021 i ka dorëzuar por të njëjtat nuk kanë qenë të nënshkruara as nga vlerësuesi por as nga i vlerësuar, kështu që referuar dispozitave ligjore gjegjësisht nenit 43 paragrafi 9 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit.",* po ashtu sipas nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, është përcaktuar se: *"1. Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesionale të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1. takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; 1.2. vlerësimin (notimi) e objektivave; 1.3. konfirmimi i vlerësimit nga i vlerësuar".* Bazuar në dispozitat e cekura si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se përveç vlerësimit që duhet bërë në SIMBNJ nga vlerësuesi, kjo nënkupton që edhe formularët duhet të jene të nënshkruar ngase konfirmimi i vlerësimit nënkupton procesin e fundit të vlerësimit që duhet të jetë nënshkrimi i aktit të vlerësimit, si rrjedhojë ankuesi nuk ka dorëzuar formularët e nënshkruar kështu që aplikacionet e mangëta refuzohen siç parashihet me dispozitat e nenit 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Pas refuzimit të aplikacionit ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës së datës 11.09.2023 së bashku me ankesën ka dorëzuar edhe formularët e vlerësimit të rezultateve në punë të nënshkruara, mirëpo në këtë rast dokumentet e dorëzuara pas afatit të aplikimit nuk pranohen siç parashihet me dispozitat e nenit 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"2. Të gjitha shpalljet e konkurimit, gjithashtu, përmbajnë këto shënime: "2.2. "Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen".*

Rrjedhimit Kolegji i Këshillit, konstaton se çështja e parashtrimit të ankesës ndaj refuzimit të aplikacionit, nuk është fazë përmes të cilës kandidatët mund të dorëzojnë edhe dokumentacionet të tjera për plotësimin e aplikacionit, ngase faza e ankesës është fazë përmes të cilës vetëm bëhet kontestimi i aktit administrativ përmes të cilit është refuzuar aplikacioni, siç parashihet me nenin 45 paragrafi 5 dh 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"5.Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve. 6.Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë NJBNJ"*, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se është anuluar konkursi ende pa u plotësuar afati kohor për ankesat e mundshme, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi i referohet njoftimit të datës 18.09.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, e që sipas Kolegjit të Këshillit ky njoftim nuk ka të bëjë fare me anulimin e konkursit por në të thuhet që të gjitha kandidatët njoftohen se ka përfunduar faza e verifikimit paraprak dhe asnjëri nga kandidatet nuk ka kaluar në fazën e mëtutjeshme, rrjedhimisht ky njoftim është bërë me qëllim të njoftimit të të gjithë kandidatëve se nuk është përmbushur kushti ligjor për kalim në procedura të tjera pa u përmbushur kushti për kalim të fazës së verifikimit paraprak, kështu që pretendimi i ankuesit nuk qëndron.

Nisur nga baza ligjore e përmendur si më lartë, dhe nga vlerësimi i provave të lëndës, respektivisht dëshmitë e dërguara nga ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedhë se ankuesi nuk ka përmbushur kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi AAPSK.Nr.732 i datës 05.09.2023 i Udhëheqësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar është nxjerr në pajtim me nenin 38 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 41 paragrafi 2, nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, paragrafi 2, nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe kërkesat e parapara me konkurs, ndërsa vendimi i kundërshtuar me ankesë Vendimi AAPSK.Nr.755 i datës 13.09.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse i njëjti është nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 38 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 45 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-

048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1238/2023, datë 01/11/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.